



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:132520

Datë: 09.11.2020

Numri i dokumentit: 01254983

P.nr.2030/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i çështjes Sabit Sadikaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.K., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.2652/2019 të datës 14.05.2019, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur me datë 09.11.2020, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Fatmir Behrami dhe të akuzuarit V. K., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, dhe përpiloi përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V. K., i biri i G.dhe B., i lindur më datë në Z., me vendbanimin në Lagjën, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 23.01.2019, rreth orës 20:30, në Prishtinë, në Lagjën U., gjatë kontrollit nga njësia e Stacionit Policor Jugu, te i pandehuri është gjetur një sasi me bari, substancë e dyshuar narkotike e llojit mariuanë në sasi prej 0.4 gram dhe një qese me pluhur të bardhë, sasi e substancës narkotike e llojit kokainë, në sasi prej 0.4 gram, të cilën e ka mbajtur në posedim pa autorizim.

Ndërsa, nga ekspertiza AFK/2019-2449/2019-2168 del se dëshmia #1 ka treguar se përmban mariuanë që përmban THC me gjurmë (indikacion) të Amfetaminës, dhe dëshmia #2 përmban Amfetaminë në përzierje me Kafeinë në peshë prej 0.12 gram.

-Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave dhe neneve 7, 17, 21, 41, 46, 51, 52,73 dhe 74 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së:

G J Y K O N

Të akuzuarin **V. K.** me dënim me gjobë në vlerë prej 100 (njëqind) **EUR.**

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzetë Euro) si dhe 30€ (tridhjetë Euro) në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mundet ta paguajë gjobën, gjykata konform nenit 46 par. 3 të KPRK-së, do të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtu që për një ditë burgim do t'i llogaritet me 20 € (njëzetë Euro) gjobë.

Konfiskohet: substancat psikotropike-narkotike e llojit marihuanë në peshë prej **0.11 gram**, si dhe **substancia e cilësuar nga ekspertiza si amfetaminë në sasi prej 0.12 gram.**

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.2652/2019 të datës 14.05.2019, ka akuzuar V. K., për kryerjen e veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin fillestar më dt.09.11.2020 dhe pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit Fatmir Behrami, dhe pasi që i akuzuari Visar Kelmendi është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-së, i njëjti është deklaruar se e pranon fajësinë lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet dhe kërkon nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit ti shqipton një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit në këtë seancë të shqyrtimit fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që pranimi i fajësisë bëhet në mënyrë vullnetare, i pandehuri është i vetëdijshëm, me pasojat e pranimit të fajësisë si dhe pranimi i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike të përshkruar në aktakuzë, i cili paraprakisht është njoftuar me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë andaj i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit, pranimin e fajësisë ta merrë si rrethanë lehtësuese, gjithashtu i pandehuri Visar për herë të parë ka ra në konflikt me ligjin e gjithashtu kjo është hera e parë që ka poseduar substancën narkotike duke mos i ditur për pasojat të cilat e presin, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht me vullnetin e tij të lirë konform nenit 248 të KPPRK-së.

Pasi që gjykata konstatoi që i akuzuari pranon në tërësi veprën penale me të cilën është ngarkuar, që i akuzuari i kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, që pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, që pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, gjyqtari i vetëm gjykues mori aktvendim me të cilin e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që vlerësoi se ky pranim ishte në përputhje të plotë edhe me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, e që të gjitha këto në mënyrë të plotë dhe të argumentuar e vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk administroi provat, por vazhdojë me matjen e dënimit.

Gjatë matjes së dënimit të akuzuarit, gjykata i vlerësoj të tëra rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe në lartësinë e dënimit konform nenit 73 të KPRK, andaj gjykata si rrethanë lehtësuese të akuzuarit i mori faktin e pranimit të fajësisë qysh në shqyrtim fillestar,

faktin se me parë nuk ka qenë i dënuar dhe pendimin e thellë për veprën penale të kryer, ndërsa rrethana rënduese për të akuzuarin gjeti rrezikshmerinë shoqërore të kësaj vepre penale, faktin se përdorimi i substanca narkotikëve është i dëmshëm për shoqërin sidomos afektimi i moshave te reja, andaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e tij si dhe do të ndikoj tek të tjerët që mos të kryejnë vepra penale çka është edhe qëllimi i shqiptimit të dënimit me kusht konform nenit 50 dhe denimi me gjobë konform nenit 46 të KPRK dhe qëllimi i shqiptimit të dënimeve të përgjithshme i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6, lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi për konfiskimin e substances narkotike u mor në bazë të nenit 275 par 3 të KPRK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2019:132520, 09.11.2020

G j y q t a r i

Sabit Sadikaj Prishtine

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimt të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2019:132520
Datë: 09.11.2020
Numri i dokumentit: 01254983